

VENDIM
Nr.823, datë 5.12.2007

PËR KRIJIMIN E DISA NJËSIVE KRYESORE, FAKULTETEVE TË UNIVERSITETIT
“EQEREM ÇABEJ”, GJIROKASTËR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 9, pika 2, 41 e vijues të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në Universitetin “Eqerem Çabej”, Gjirokastrë, krijohet Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore, nga bashkimi i ish-Fakultetit të Shkencave të Edukimit dhe ish-Fakultetit të Shkencave Shoqërore.

2. Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore, ka në përbërje këto departamente:

- Departamentin e Shkencave të Edukimit dhe të Metodologjisë së Mësimdhënies, që krijohet nga bashkimi i ish-Departamentit të Shkencave të Edukimit dhe ish-Departamentit të Arsimit Parashkollor;

- Departamentin e Gjuhëve të Huaja;

- Departamentin e Gjuhës, Letërsisë dhe Qytetërimit Grek;

- Departamentin e Historisë dhe Gjeografisë;

- Departamentin e Gjuhës dhe Letërsisë;

- Departamentin e Ekonomisë.

3. Universiteti “Eqerem Çabej”, Gjirokastrë, për vitin akademik 2007-2008, do të vazhdojë të ofrojë të njëjtat programe studimi, që ka ofruar me fillimin e këtij viti akademik.

4. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti “Eqerem Çabej”, Gjirokastrë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha